



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. 7899/prot.

Tiranë, më 22 . 12 .2025

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1547, datë 07.06.2011.

SHOQËRISË “BREGU-ADRIATIK” SH.P.K

Rr. “Loni Ligori”, Pallati “Alb Adriatik”, Shkalla 3, Dyqani Nr.4, Yzberisht, Kashar, Tiranë

Për dijeni: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**

Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “BREGU-ADRIATIK” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1547, datë 07.06.2011, për mineralin krom, në Objektivin “Kreshta e Pacit, Bytyç”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 4368 prot., datë 11.11.2025, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 7899 Prot., datë 13.11.2025, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1547, datë 07.06.2011, për mineralin krom, në Objektivin “Kreshta e Pacit, Bytyç”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës, nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2025-2026.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 1547, datë 07.06.2011, për mineralin krom, në Objektivin “Kreshta e Pacit, Bytyç”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 “Procedura e revokimit të lejes”, keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1547, datë 07.06.2011, për mineralin krom, në Objektivin “Kreshta e Pacit,

Bytyç", Bashkia Tropojë, Qarku Kukës, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

DHE

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME URDHËR PËR DELEGIM

ZËVENDËSMINISTRI

BESJAN KADIU

